TË FTUAR PËR TË JETUAR SI MËKËMBËS...

RAMAZANI, PËRSE ËSHTË MUAJ I BEKUAR...

RAMAZANI, "ANIJA E SHPËTIMIT"

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 19 - Nr. 4 (218), Prill, 2021

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Ramazani, muaji i përkushtimit dhe i solidaritetit me njerëzit në nevojë!

Muaji i Madhëruar i Ramazanit është një mundësi e mrekullueshme që na përsëritet një herë në çdo 12 muaj, për ta rikujtuar besën e origjinës sonë, besimit e përkushtimit, në të cilin ftohemi për të jetuar me nder, mbështetur mbi urtinë shekullore: "Zoti im, Ti je qëllimi im dhe pëlqimi Yt është kërkesa ime!".

H. FEJZI ZAGANJORI, NJERIU I PAJTIMIT DHE I HARMONISË..!

Pasditën e së enjtes, më 8 prill 2021, faltorja e Rusit ishte tejmbushur si asnjëherë tjetër më parë!

Besimtarë të shumtë nga çdo cep i qytetit, kishin ardhur për të marrë pjesë në xhenazen e të dashurit e të respektuarit Haxhi Fejzi Zaganjori, që u nda nga jeta në orët e para të kësaj dite, në moshën 76 vjeçare.

Qytetarë të shumtë shkodranë, por edhe të ardhur nga Tirana, Dibra, Durrësi, Kopliku, etj., ishin aty së bashku për të bërë nderimet e fundit në prag të përcjelljes së imamit e vaizit ... *(f.6)*

SHKODRA DHE PRIZRENI NË TRADITËN E VËLLAZËRISË ISLAME

Ditën e martë, më 20 prill 2021, me ftesë të Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Mr. Besim Berisha, Myfti i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në iftarin tradicional që bashkon dy myftinitë e binjakëzuara në sofrën e vëllazërisë islame.

Ndonëse në kushtet e pandemisë, iftari simbolik, bashkoi në tryezën bujare drejtuesit e dy myftinive, që diskutuan edhe për frymën e bashkëpunimit dhe rritjen e tij në të ardhmen në të mirë të besimtarëve dhe dy qyteteve me traditë e histori... *(f.15)*

TË FTUAR PËR TË JETUAR SI MËKËMBËS...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të dashur e të shtrenjtë besimtarë!

Tashmë që kaluan 10 ditët e para të Muajit Ramazan 1442, të gjithë jemi të ftuar të mendojmë e të punojmë në drejtim të cilësisë së jetës mbi tokë; të mendojmë se sa shpejt kalon koha dhe sa të papërsëritshme janë mundësitë për të lënë një gjurmë të mirë, mbi të gjitha të pranuar nga Zoti i gjithësisë, gjurmë që sjell dobi për vete e për të tjerët, bazuar mbi fjalën e urtë të Resulullahut (a.s): "Njerëzit janë krejt krijesa të Allahut, dhe më i dashuri i tyre tek Allahu është më i dobishmi i tyre për ta!".

Jemi të ftuar të punojmë për përmirësimin e cilësisë së jetës mbi tokë, duke kuptuar drejtë se çfarë do të thotë për njeriun cilësimi që Allahu i Madhëruar i bën sojit të tij përpara melekëve: "Unë po vendos në tokë një *mëkëmbës*...".

Çfarë do të thotë *mëkëmbës*? Mëkëmbës i Zotit është ai, që jeton me nder e dinjitet, plot besim e përkushtim, që përpiqet për të mirën, pa paragjykimin e askujt, që ndërton urat e paqes, që mbron me dinjitet e krenari shenjtërinë e fesë, jetës, mendjes, pasurisë e nderit, që mendon e vepron duke vështruar larg e duke bërë llogaritë e tij, si ta dinte se do largohet të nesërmen e çdo dite nga kjo botë!

Muaji i Madhëruar i Ramazanit është një mundësi e mrekullueshme që na përsëritet një herë në çdo 12 muaj, për ta rikujtuar besën e origjinës sonë, besimit e përkushtimit, në të cilin ftohemi për të jetuar me nder, mbështetur mbi urtinë shekullore: "Zoti im, Ti je qëllimi im dhe pëlqimi Yt është kërkesa ime!".

Mësojmë vit pas viti të agjërojnë gjymtyrët tona; mendja, gjuha, dora, syri, zemra, këmba, veshi, por jo vetëm, në mënyrë që cilësia e jetës sonë të përmirësohet, drejtësia e mirëqenia të dominojnë, siguria e respektimi në komunitet të jenë adresë, harmonia dhe vëllazëria të shihen natyrshëm në çdo komunikim, kultura dhe etika të jenë shenjë dalluese, dituria dhe thellimi në shkencat e ndryshme të saj të ngelen pikësynim i brezave, përkujdesja për prindërit dhe moshën e tretë të jetë shembull për çdo shoqëri, mbrojtja e natyrës dhe kujdesi për kafshët të jetë thirrje e natyrshme gjenetike, dashuria për të bukurën dhe mbrojtja e trashëgimisë të qarkullojë si gjaku në vena, respektimi i pronës private dhe vlerësimi i mendimit të dëshmohet si shenjë qytetëruese, dialogu dhe larmia e platformave për të mirën e shoqërisë dhe vendit, sinjal i pjekurisë intelektuale dhe kulturës së të jetuarit në zhvillim, fushatat elektorale dhe zgjedhjet sipas cikleve legjitime dëshmi e përgjegjësisë për të mirën e atdheut dhe kombit, vullnet i padiskutueshëm i dëshirës për zhvillim, përparim e mirëqenie për popullin, respektimi i kufijve të ligjit e mbi të gjitha ato të besimit shprehje e origjinalitetit në marrëdhënie me jetën në kushte elitarizmi!

Muaji i Ramazanit të sivjetshëm në vendin tonë mbërriti në një situatë shumë më të mirë e më komode për ne besimtarët, se ai i vitit që kaloi, ku si rezultat i masave të marra për shkak të pandemisë, u mbyllëm dhe e jetuam Ramazanin në kushte të padëshiruara, sipas rregullit: "politika e të mundurës"!

Këtë vit, falënderuar qoftë Allahu, lutjet e besimtarëve u pranuan, oraret e lëvizjes u shtynë në dobi të aktivitetit fetar e jetës së xhamisë, teravitë po i shijojmë e namazet po i falim nëpër xhami, njëkohë që në mbarë botën, kufizimet për shkak të pasojave të pandemisë, kanë mbyllur shumë e shumë prej qendrave të botës islame, a e kanë kufizuar dukshëm normalitetin e këtij muaj, sikurse e dini dhe e ndiqni nëpërmjet burimeve të larmishme të informacionit.

Duhet ta falënderojmë Allahun për këtë mirësi, por njëkohësisht duhet të kuptojmë vlerën e madhe të besimit e të fesë në jetën tonë, duke e përkthyer këtë falënderim me përkushtim për të ndryshuar përditë e më shumë në drejtim të reflektimit të fetarizmit të shëndoshë e të ekuilibruar në praktikën e të jetuarit!

Resulullahu (a.s) na mëson se: "Kush nuk e lë gënjeshtrën dhe të punuarit me të, Allahu nuk ka nevojë për ushqimin dhe pijen e tij!".

Pra, o muslimanë, dëshmojeni frymën e agjërimit në marrëdhëniet e përditshme, në shitblerje, në shtëpitë tuaja, në politikëbërje në shërbim të popullit e interesit kombëtar, në shkollë, në universitete, në punishta e fabrika, në çdo drejtim!

E gjitha kjo, që jeta e jonë të përmirësohet, që komunikimi të rritet në nivelin e tij, që kultura e përgjithshme të pasurohet në vazhdimësi, që brezat të kalojnë stafetën e vlerave, duke merituar bekimet dhe mëshirën e Zotit!

Motra dhe vëllezër!

Ramazani është muaj i solidaritetit me njerëzit në nevojë, një pjesë të dhimbjes së të cilëve e ndjen secili agjërues, që nëpërmjet fitimeve të këtij Muaji, është i ftuar të punojë për luftimin e varfërisë e skamjes, nëpërmjet çdo rruge legjitime, që shpie në realizimin e këtij qëllimi të lartë fetar e kombëtar!

Të dielën e 25 prillit 2021, Shqipëria voton! Secili prej nesh, duhet ta ndjejë si përgjegjësi të madhe kombëtare, të mos e neglizhojë të drejtën e tij legjitime, që përkthehet në një përpjekje sociale për më të mirën e vendit dhe jetës sonë, në kushtet e këtij sistemi!

Dilni dhe votoni, me lutjen e ditës së Ramazanit, që ky vend e kjo tokë të kenë përherë bekimet e Zotit, që shqiptari të jetojë në harmoni e vëllazëri me shqiptarin, që diversiteti të na shtyjë përherë e më shumë drejt respektimit dhe gatishmërisë për të bashkëpunuar për të mirën e Shqipërisë sonë të shtrenjtë, për të sotmen e rinisë dhe të ardhmen e fëmijëve!

A ka keq atdheu e kombi ynë nëse pasuritë e panumërta natyrore, që na i ka falur Zoti, të përpiqemi t'i mbrojmë, t'i shfrytëzojmë, t'i vlerësojmë e t'i përdorim në shërbim të interesit kombëtar, shoqërisë e mirëqenies në këtë vend?

A ka të keq atdheu e kombi nga përpjekja e secilit prej nesh për të jetuar me dinjitetin e besimit, respektimin dhe mbrojtjen e jetës, vlerësimin e tjetrit si krijesë e Zotit Një, ndihmën e pakursyer për ata që e meritojnë dhe përkrahjen e brezit të ri për të ecur me hapa të qëndrueshëm drejt së ardhmes së rrethuar me bekimet e Krijuesit?

A ka të keq atdheu e kombi nga sensibilizimi i gjithanshëm për respektimin e kufijve të zekatit dhe ndarjes së tij, sipas rregullave të përcaktuara islame, në dobi të kategorive përfituese dhe projekteve për të cilat vlen të ndahet, që mbi të gjitha janë një kontribut i drejtpërdrejtë në eliminimin a zbutjen e varfërisë e skamjes?

Me qindra familje shkodrane, e kalojnë këtë muaj të shenjtë shumë më mirë se çdo muaj tjetër, falë zekatit tuaj, sadekave bujare dhe ndihmave vëllazërore nga Kuvajti, Arabia Saudite, Turqia, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe, etj. A nuk është kjo një mirësi e jashtëzakonshme, për të cilën duhet të punojmë edhe më shumë?

Vëllezër e motra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Italia, etj., nuk janë kursyer për të na kontaktuar gjatë këtij Muaji, për të ndarë nëpërmjet Myftinisë Shkodër, sadekatë dhe zekatin e tyre për njerëz në nevojë!

Subhanallah, më pasuron në zemër e shpirt ky garim për të mirë, ky shpirt altruist, kjo dhembshuri e kjo frymë elitare e komunikimit në mesin e njerëzve, Allahu i begatoftë!

Por, duhet të punojmë në vazhdimësi, të korrigjojmë veten, të mos përsërisim gabimet e kaluara, të mos biem në batakun e vetëkënaqësisë, të shtrijmë dorën e bashkëpunimit e të kërkojmë me dinjitet legjitim, atë që e kemi pjesë thelbësore të misionit tonë të Thirrjes Islame dhe, për të cilin punojmë me krejt energjitë tona, duke u ndjerë krenarë çdo ditë e më shumë!

Të dashur të pranishëm dhe ju të shtrenjtë që na ndiqni nëpërmjet rrjeteve sociale dhe mediave në përgjithësi!

Të dielën e 25 prillit 2021, Shqipëria voton! Secili prej nesh, duhet ta ndjejë si përgjegjësi të madhe kombëtare, të mos e neglizhojë të drejtën e tij legjitime, që përkthehet në një përpjekje sociale për më të mirën e vendit dhe jetës sonë, në kushtet e këtij sistemi!

Përse Resulullahu (a.s) udhëzoi sahabët e tij të emigronin nga Meka e bekuar drejt Habeshesë, që e drejtonte një mbret, për të cilin ai zotni tha: "... tek i cili nuk i bëhet kujt padrejtësi!"?

Ky është një mësim i madh në historinë e ruajtjes së dinjitetit të mëkëmbësit të Zotit në tokë! Si për të na thënë, se në rrugën e kërkimit të më të mirës, nuk ka pushim, nuk ka gjumë, nuk ka dorëzim, nuk ka neglizhencë e nuk ka kthim shpine!

Dilni dhe votoni, me lutjen e ditës së Ramazanit, që ky vend e kjo tokë të kenë përherë bekimet e Zotit, që shqiptari të jetojë në harmoni e vëllazëri me shqiptarin, që diversiteti të na shtyjë përherë e më shumë drejt respektimit dhe gatishmërisë për të bashkëpunuar për të mirën e Shqipërisë sonë të shtrenjtë, për të sotmen e rinisë dhe të ardhmen e fëmijëve!

Lutuni në sexhde e pas çdo namazi për Shkodrën, për Shqipërinë, tamam siç lutej Resulullahu (a.s) për vendlindjen e tij e për Medinen e Ndriçuar: "Zoti im, begatoje Medinen, sa dyfishi i begatisë që i ke dhënë Mekës!".

Lutuni dhe punoni me të gjitha rrugët legjitime, që thelbi i duasë tuaj që del nga zemra, të dëshmohet në tokë, që secili prej nesh e fëmijët tanë të jetojnë me dinjitetin e të përkufizuar në Kuran: "mëkëmbës" i Zotit, i ftuar për të befasuar edhe melekët me përkushtimin dhe lartësinë e tij!

Lutuni dhe jetoni lart, me krejt përzgjedhjet tuaja të urta e largpamëse për të mirën e të sotmes e të ardhmes së këtij vendi, që Allahu e caktoi të jetë atdheu ynë, brez pas brezi!

Allahu i Madhëruar e begatoftë Shkodrën tonë, Shqipërinë e shtrenjtë dhe i gëzoftë zemrat e shqiptarëve me dritën e dashnisë së Tij!

(Hytbeja e mbajtur në xhaminë e Parrucës, Shkodër, më 23 prill 2021)



Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

"Disa kanë frikë se mos gëlltisin një pikë ujë e të prishin agjërimin e tyre... e, nuk kanë frikë të gëlltisin të drejtat e njerëzve dhe të prishin ahiretin e tyre!"

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS, ME RASTIN E MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1442/2021

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër dhe motra besimtare!

Me mbarësinë e Allahut (xh. sh) sonte me namazin e akshamit të gjithë në bëhemi gati për të hyrë në atmosferën e begatë të muajit të madhërueshëm të Ramazanit.

Ditën e nesërme, më 13 prill 2021 nisim agjërimin e ditës së parë të këtij muaji të madhërueshëm që e presim me mall dhe me zemër të madhe.

Ditën e sotme kisha një bashkëbisedim me një djalë të ri besimtar, i cili po më pyeste rreth disa shokëve të tij që konsumonin alkoolin, mirëpo që kishim bërë nijet të agjëronim Ramazanin e këtij viti, dhe po më thoshte: "A lejohet që ata, të cilët deri dje kanë konsumuar alkool të agjërojnë sivjet?"

Subhanallah, pata një gëzim shumë të madh në zemër dhe i thashë: Patjetër, Allahu (xh.sh) është i gëzuar dhe i bekon me mëshirën e Tij të gjithë ata që heqin dorë nga gjynahet e nga ndalesat dhe përkushtohen në këtë muaj të madhërueshëm të Ramazanit për të nisur një jetë të re dhe një marrëdhënie të re me Zotin e gjithësisë!

Që do të thotë se, të gjithë ne kemi mundësinë që me fillimin e muajit të madhërueshëm të Ramazanit të përmirësojmë diçka nga sjellja e jonë, nga komunikimi ynë, nga marrëdhënia jonë me të tjerët, në mënyrë që të afrohemi dhe të lartësohemi në gradët më të larta të përkushtimit dhe me njëri-tjetrin.

Të dashurit e mi, muaji i madhërushëm i Ramazanit nuk është muaji i të qëndruarit thjeshtë pa ngrënë dhe pa pirë nga një moment deri në një tjetër, nga një cak në një tjetër, porse është mundësi e madhe që na jepet nga Zoti i gjithësisë, që të agjërojnë gjymtyrët tona nga gënjeshtra, nga mashtrimi, nga zilia, nga përtacia, nga çdo gjë e keqe që na ndalon për t'u afruar me Zotin e gjithësisë.

Është momenti që të largohemi dhe të distancohemi nga thashethemnaja, nga përgojimi, nga përfolja e të tjerëve, dhe të punojmë me sa të kemi mundësi që t'i dëshmohemi Zotit të gjithësisë si robërit e Tij të përkushtuar, në mënyrë që kur të vijë momenti i iftarit, të themi me zemër: Zoti im për Ty agjërova! Pra, për Ty nisa një rrugëtim të ri për t'u bërë më i mirë, dhe për t'u dëshmuar njeri ndërtues në realitetin ku unë jetoj.

Sonte, të bëhemi gati me zemër të madhe për këtë mik të madh që na vjen nga Zoti i gjithësisë, për të marrë bekime dhe për të shpresuar për më të mirën!

Vitin që kaloi e kishim të vështirë agjërimin në kushtet si ishim. Sivjet, falë Zotit që i pranoi lutjet e shumta të besimtarëve, situata është pak më e përmirësuar, që do të thotë se ne jemi të ftuar nga Zoti i gjithësisë të vlerësojmë çdo moment të dashurit e mi! Çdo ditë e re është një mundësi e re, çdo ditë e re është një mundësi nga Zoti i gjithësisë për ta falënderuar Atë për jetën që na ka dhënë, për ta falënderuar Atë për mirësitë që na ka dhënë, dhe nëpërmjet tyre të ecim përpara me sa të kemi mundësi, të krijojmë hapësira të reja të së mirës, për ta ndërtuar të mirën, për ta zhvilluar të mirën, dhe për të lënë gjurmë të mira, sepse nuk dihet kur do të largohemi nga kjo botë!

Sivjet e nisim Ramazanin dhe shumë prej të afërmve dhe prej të dashurve e të shtrenjtëve tanë nuk janë me ne në mesin tonë, që do të thotë se, të gjithë jemi të ftuar nga Zoti i gjithësisë për ta falënderuar Atë për mundësinë e madhe të jetës dhe të komunikimit dhe të besimit që na ka dhënë, në mënyrë që sa të jemi në këtë botë dhe sa të jemi në këtë jetë të ndërtojmë të mirën dhe të punojmë për të!

Të distancohemi nga e keqja, të distancohemi nga haramet, e të distancohemi nga çdo gjë për të cilat nuk është razi Zoti i gjithësisë.

Të dashurit e mi, po vjen Ramazani, i cili mund me dritën e Zotit çdo të keqe përreth nesh! Po vjen Ramazani, le ta përhapim gëzimin e madh të këtij muaji të begatë, dhe të jetojmë me përkushtimin e këtij muaji të shtrenjtë duke dëshmuar besimin në Allahun, dashamirësinë për njëri-tjetrin, dashninë për tokën dhe atdheun tonë!

Allahu ju dashtë dhe ju pastë në mbrojtjen e Tij! Me zemër të mirë Ramazanin !

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

(Mesazhi i urimit me rastin e fillimit të Muajit Ramazan 1442/2021)



"Është momenti që të largohemi dhe të distancohemi nga thashethemnaja, nga përgojimi, nga përfolja e të tjerëve, dhe të punojmë me sa të kemi mundësi që t'i dëshmohemi Zotit të gjithësisë si robërit e Tij të përkushtuar, në mënyrë që kur të vijë momenti i iftarit, të themi me zemër: Zoti im për Ty agjërova!"

XHUMAJA E PARË E RAMAZANIT 2021/1442 NË XHAMITË E SHKODRËS

Në të gjitha xhamitë e Shkodrës u fal xhumaja e parë e muajit të madhëruar të Ramazanit 2021/1442 me pjesëmarrjen e shumë besimtarëve të moshave të ndryshme, të cilët përjetuan kënaqësinë gjatë dëgjimit të hytbes në lidhje me rëndësinë dhe vlerën e madhe që ka Ramazani, si dhe më pas për namazin dhe lutjet që kryejnë në shtëpitë e Zotit Fuqiplotë, ndryshe nga viti i kaluar, që për shkak të kufizimeve nga pandemia e koronavirusit nuk kishim mundësi të falin namazin e xhumasë në xhami.

Nga xhamia e "Dy Vajzave", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari tërhoqi vëmendjen ndaj hakut të Kur'anit në jetën e muslimanit. Ndër të tjera tha: "Kurani është Libri i Zotit të gjithësisë, që i drejtohet mbarë njerëzimit, jo vetëm muslimanëve. Kurani është i mbarë njerëzimit, sepse është esenca e të gjitha librave të mëparshëm. Në Kuran do të gjesh gjurmët e Teuratit, do të gjesh thelbin e Inxhilit, do të gjesh esencën e Zeburit, sikurse do të gjesh thelbin e fjalëve të pejgamberëve të mëparshëm...!".

Myftiu nënvizoi se madhështia e këtij muaji është në sajë të madhështisë që ka vetë Kurani Famëlartë, i cili ka filluar të zbresë në këtë muaj të begatë, si udhërrëfyes për mbarë krijesat e Zotit (xh.sh).

Ndërkohë nga minberi i xhamisë "Ebu Bekër", imami i saj, H. Idmir Plaku u përqendrua tek tema: "Muaji i Ramazanit, muaj i ndryshimit". Ai gjatë hytbes vuri theksin te ndryshimi i sjelljes së besimtarit, me synimin për të qenë gjatë këtij muaji dhe në vijim, më afër Zotit, pikërisht me moralin më të mirë, me ndryshimin e pozitës së besimit drejt një qasje më pranë qëllimit për të cilin është krijuar, që është adhurimi i Zotit dhe për t'iu mbështetur vetëm Atij në çdo situatë, në çdo kohë dhe në çdo vend.

Në xhaminë e Tepes, teologu Arben Halluni foli mbi: "Urtësitë që ka secili adhurim". Ai tha se: "Zoti (xh.sh) në çdo adhurim si namazi, zekatin, agjërimi, haxhi etj, ka vendosur urtësinë, vlerën dhe shpërblimin. Janë pikërisht këto elementë që duhet të nxisin çdo besimtarë në udhën e ndriçimit të zemrës me devotshmëri dhe besim permanent dhe të vërtetë!" Teologu Halluni në mes të tjerave tha se agjërimi i Ramazanit na ndihmon ne që të lartësohemi moralisht, fizikisht dhe shpirtërisht...".

Një mesazh me vlerë ishte edhe ai i dhënë nga imami i xhamisë së Medresesë, H. Adil Cukali, i cili iu drejtua besimtarëve me temën: "Veçoritë e Ramazanit". Në këtë hytbe ai tha se: "Agjërimi i Ramazanit dallohet nga të gjitha ibadetet dhe atë Allahu (xh.sh) e ka quajtur muaj të nderuar dhe të bekuar në zemrat e besimtarëve. Agjërimi është muaji që në të zbriti fluksin e parë të ajeteve të Kuranit Famëlartë nëpërmjet Shpirtit Fisnik (Xhebrailit) tek zemra e të dërguarit të Allahut. Muhamedi (a.s): "Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)."

Në fund të çdo xhumaje në xhami të ndryshme të qytetit dhe jo vetëm u bënë dua-lutje, këndim salavatesh si dhe besimtarët e pranishëm uruan njëri-tjetrin: Me zemër të mirë Ramazanin dhe Zoti e bëftë një muaj plot mirësi dhe të pranuar!

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Ju erdhi Ramazani muaji i begative të Allahut në të cilin zbret mëshira, fshihen gjynahet dhe pranohen lutjet. Allahu ju vështron duke bërë gara me njëri-tjetrin në adhurime dhe mburret me ju te meleket e Tij. Prandaj shpalosni prej vetes tuaj vepra të mira, sepse i humbur dhe i dëshpëruar është ai njeri, i cili privohet nga mëshira e Allahut në këtë muaj."

(Transmetuar nga Tabaraniu)

H. FEJZI ZAGANJORI, NJERIU I PAJTIMIT DHE I HARMONISË..!

Pasditën e së enjtes, më 8 prill 2021, faltorja e Rusit ishte tejmbushur si asnjëherë tjetër më parë!

Besimtarë të shumtë nga çdo cep i qytetit, kishin ardhur për të marrë pjesë në xhenazen e të dashurit e të respektuarit Haxhi Fejzi Zaganjori, që u nda nga jeta në orët e para të kësaj dite, në moshën 76 vjeçare.

Qytetarë të shumtë shkodranë, por edhe të ardhur nga Tirana, Dibra, Durrësi, Kopliku, etj., ishin aty së bashku për të bërë nderimet e fundit në prag të përcjelljes së imamit e vaizit të shquar të Rusit, Shkodrës e përtej!

Imamllarë, myftilerë, intelektualë, studiues, pedagogë, drejtues të shoqatave, prijës të komuniteteve fetare të Shkodrës, miq e dashamirë të Haxhi Fejzi Zaganjorit, ishin dorë për dore, duke dëshmuar mrekullinë e mozaikut të vlerave të harmonisë e bashkëjetesës, afrimit e bashkimit, në të mirë e në të keq, që na forcon edhe më shumë si popull e si komb i qytetëruar!

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Prefektja e Qarkut Shkodër, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, drejtues të partive politike shqiptare, instituteve islame, brenda vendit dhe jashtë tij, dërguan mesazhe ngushëllimi, duke shprehur dhimbjen për lajmin e ndërrimit jetë të kolegut, mikut e bashkëpunëtorit të zellshëm, Haxhi Fejzi Zaganjori!

Nuk është e vështirë të kërkosh për kontributet e zotnisë së tij, sidomos në tridhjetë vitet e fundit të jetës së tij.

Emisione radiofonike, shkrime e kronika, analiza e studime, pjesëmarrje

aktive në pajtimin kombëtar, prijës elokuent e karizmatik në krye të burrave të urtë, muslimanë e të krishterë, në përpjekje dorë për dore, për afruar e paqtuar njerëz në hasmëri të vjetra e të reja, hatib e vaiz i paharruar, antar i këshillit të përgjithshëm të KMSh-së ndër vite, sekretar i Këshillit të Myftinisë Shkodër e "Mirënjohja e Bashkisë Shkodër", janë disa shenja dalluese në jetëshkrimin e burrit të urtë e fjalëmirë, H. Fejzi Zaganjori!

U largua nga kjo botë me pengun e mospërfundimit të hatmes së Kuranit për muajin Shaban, që i paraprin Ramazanit Mubarek, në të cilin, për çdo vit ai me xhematin e nderuar të xhamisë së Rusit, nuk e lanë pas dore traditën shekullore të Hatmes Sherife!

U largua, pasi mori abdes dhe i kaloi çastet e fundit të vetëdijes normale me namaz e lutje drejtuar Atij që na e ka falur jetën për të lënë gjurmë drite, mirësie, udhëzime e paqeje, që patjetër i gjejmë të panumërta në jetën dhe aktivitetin e të dashtunit tonë!

Allahu i Madhëruar ta pranoftë sakrificën, heshtjen e urtë dhe fjalën guximtare, hytbet e zjarrta e mesazhet largpamëse, nxitjen për paqtim e harmoni, e mbi të gjitha besnikërinë ndaj shpirtit të traditës e vlerave islame e atyre kombëtare!

Dhe, siç na ngushëlloi edhe i nderuari Dr. Salahudin Keftaro, nga Damasku i Sirisë së vlerave dhe qyterimeve: *"Të mëshiroftë Allahu, i nderuar hoxhë dhe inxhinier Fejzi Zaganjori!*

Allahu të dhashtë postin e fatlumëve në jetën e përtejme!

E ndjeja besimin tuaj, forcën e vullnetit, dashurinë, sinqeritetin dhe xhelozinë tuaj për fenë dhe shërbimet tuaja për atdheun tuaj!

Të gjithë ne do të shkojmë një ditë, dhe unë i lutem Allahut që të takohemi me të dashurit tanë dhe me ju tek Kroi i Resulullahut (a.s), nën flamurin e Zotërisë së të Dërguarve!

I lutem Allahut që trashëgimtarët tuaj, prej të afërmve dhe të rinjve, të vazhdojnë rrugën tuaj, që të gëzoheni me frutet e veprës që i kushtuat jetën!".

Mirë u pjekshim në Ma të Mirin Vend, i dashtuni Haxhi Fejzi Zaganjori!

Imam Muhamed Bardhyl Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 9 prill 2021

- HOMAZHE -

VOLTANA ADEMI,
KRYETARE E BASHKISË SHKODËR

"Shkodra humbi sot një vlerë të qytetit. Haxhi Fejzi Zaganjori ndërroi jetë duke lënë dhimbje e pikëllim tek familja, të afërmit, miqtë e shokët që e njohën nga afër por edhe prej larg.

Një zotni Shkodre, një klerik që rrezatonte paqe, mirësi dhe këshilla të vlefshme, nga sot do na mungojë të gjithëve. Unë dua ta kujtoj gjithmonë me një këshillë që ma përsëriste shpesh: "I madhi Zot të ndihmoftë, mos len derë pa kersitë për të drejtën".

Qofsh banor i xhenetit!

Pushofsh në paqe Haxhi Fejzi Zaganjori!"

MAJLINDA ANGONI
PREFEKTE E QARKUT SHKODËR

"Me humbjen e figurës së shkëlqyer të Haxhi Fejzi Zaganjorit, qytetarët dhe komuniteti mysliman #Shkodër humbën udhëheqësin e tyre shpirtëror, qytetarin e denjë, aktivistin e zellshëm të harmonisë kombëtare i cili me frymën dinjitoze, shpresëdhënëse dhe zemërgjerësinë e tij lartësoi imazhin e fesë duke kontribuar në peisazhin tonë fetar me intelektualizmin dhe përultësinë e tij të sinqertë.

Allahu e mëshiroftë me Xhehnet!"

DR. SALAHUDIN KEFTARO,
NGA DAMASKU I SIRISË SË VLERAVE DHE QYTERIMEVE:

"Të mëshiroftë Allahu, i nderuar hoxhë dhe inxhinier Fejzi Zaganjori!

Allahu të dhashtë postin e fatlumëve në jetën e përtejme!

E ndjeja besimin tuaj, forcën e vullnetit, dashurinë, sinqeritetin dhe xhelozinë tuaj për fenë dhe shërbimet tuaja për atdheun tuaj!

Të gjithë ne do të shkojmë një ditë, dhe unë i lutem Allahut që të takohemi me të dashurit tanë dhe me ju tek Kroi i Resulullahut (a.s), nën flamurin e Zotërisë së të Dërguarve!

I lutem Allahut që trashëgimtarët tuaj, prej të afërmve dhe të rinjve, të vazhdojnë rrugën tuaj, që të gëzoheni me frutet e veprës që i kushtuat jetën!".

XHEMAL SAFERTI
PEDAGOG NË UNIVERSITETIN BEDËR

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!

Në këtë ditë, kombi shqiptar dhe shoqëria myslimane humbën një njeri, por vepra e tij nuk është zhdukur.

Shejh Imam Fejzi Zaganjori, Zoti i Plotfuqishëm e mëshiroftë, e bëftë banor të Xhenetit së bashku me profetët, të drejtët, dëshmorët, të mirët, e sa shoqëri e mirë që janë ata.

Ai jetoi në skenën shqiptare në kohë të mira e të këqija, e kuptoi mirë fatkeqësinë e madhe që njerëzit përjetuan në fenë e tyre. U shfaqën padrejtësitë, feja u ndalua, dhe po të mos kishin qenë ata të rinj që besuan Zotin e tyre, ndoshta edhe besimi do të ishte zhdukur. Ishin pikërisht ata që e mbartën këtë besim në thellësitë e zemrave të tyre dhe më pas ua përcollën atë brezave

të cilët lindën në një periudhë pa fe dhe besim, një vepër e cila prodhoi një dritë në rritje progresive e cila sa vinte forcohej e zgjerohej ditë pas dite.

Besojini Zotit, dhe ata i besuan. Ai iu mësoi kombeve dhe brezave të rinj që kjo fe është feja e Zotit, i Cili nuk e braktis atë, se e ardhmja ju përket të devotshmëve, dhe se Zoti i Madhërishëm përgatit për këtë fe dikë që e mbart atë në çdo vend dhe në çdo kohë. Kështu, për besimtarët në Shqipëri sprova nuk shkaktoi gjë tjetër veçse forcoi durimin dhe këmbënguljen e tyre.

Sot, një nga këta heronj largohet pasi ka ecur në rrugën e thirrjes në fenë e Zotit në mënyrën më të bukur e fisnike, me guxim, mençuri dhe besnikëri, duke rimbjellë dhe njëherë farën e besimit në kraharorët nga ku për një kohë të gjatë kishte humbur ky besim, duke ngritur urat e dashurisë midis brezave të një populli.

Zoti i Plotfuqishëm të mëshiroftë o i dashur, që më doje dhe të doja për kënaqësinë e Zotit.

Me lejen e Allahut, tek Ai është takimi ynë!"

NEKROLOGJI – HAXHI FEJZI ZAGANJORI

HAXHI FEJZI ZAGANJORI

U lind në Shkodër, në lagjen Rus, më 23 mars 1945

ARSIMIMI:

Shkollën fillore dhe 7-të vjeçare, 1958

Shkollën e mesme "Jordan Misja", Shkodër, 1963

Universitetin Bujqësor në Tiranë, fakulteti i Inxhinierisë Pyjore, i diplomuar "Inxhinier Pyjesh", 1969

MËSIMET FETARE

Para viteve '90:

Ka përfunduar mejtepin në Xhaminë e Rusit me mësues besimi Hafiz Sabri Koçin.

Ka marre mësime individuale gjatë qëndrimit në Tiranë për pesë vite te ish drejtori i medresesë, Hafiz Sherif Putra me porosi të Hafiz Sabri Koçit.

Gjate kohës së pushimeve studentore në Shkodër ka marrë mësime tek Hafiz Sheuqet Boriçi, mbasi Hafiz Sabri Koçi ishte i burgosur.

Nga viti 1980 ka marrë mësime tek prof. Ismail Muça.

MBAS RIFILLIMIT TË BESIMIT E TË HAPJES SE XHAMISË SË PLUMBIT

Pas viteve '90:

Ka marrë mësime në shkencat e ndryshme islame për 12 vjet rresht.

Ka përfunduar si nxënës për 4 vite, çdo ditë Medresenë në Bushat, që njihej nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe ka marrë Ixhazetin, (diplomë) dhe është diplomuar "Imam Hatib" dhe "Vaiz".

Ne vitin 1998 ka krye detyrën e Haxhit .

TRAJNIME FETARE, SOCIALE DHE SHËRBIME TË NDRYSHME

Ixhazet (diplomë), 1996

Certifikatë për seminarin kualifikues të dhënë nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

Certifikatë Mirënjohjeje ndër 10 imamët e vitit 2010 të dhënë nga Myftinia Shkodër.

Certifikatë "Respekt" për kontributin për zhvillim e përmirësimin e jetës komunitare, e dhënë nga shoqata e gruas "Hapa të Lehtë".

Certifikatë Mirënjohjeje për angazhimin e ruajtjes se traditës shekullore të "Hatmes Sherife" dhënë nga Myftinia Shkodër.

Certifikatë Mirënjohjeje për kontributin në gazetën "Udha Islame" dhënë nga Myftinia Shkodër.

Certifikatë Mirënjohjeje për kontributin në gazetën "Drita Islame" akorduar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

Diplomë nga Misioni i Pajtimit Mbarëkombëtar Shqiptar me motivacion: "Për kontribut të veçantë për krijimin e misionit të pajtimit Mbarëkombëtar Shqiptar dhe për parandalimin dhe pajtimin e konflikteve në gjithë trojet shqiptare"

Certifikate trajnimi dhe kontribute të mendimeve të ndalimit të konflikteve ndërfetare të dhënë nga USAIDI, trajnim me dy faza në vitin 2004 dhe në vitin 2005.

Certifikatë së bashku me dinstiktivin e paqes dhuruar nga Vatikani me rastin e lutjes në Tropojë për Kosovën në kohën fillimit të luftës.

Në vitin 2019, Këshilli Bashkiak i Shkodrës i akorduar titullin "Mirënjohja e qytetit"

DETYRAT FETARE

Që në fillim të rifillimit të riorganizimit të Myftinisë Shkodër ka marrë pjesë në organizimin të punëve dhe ndjekjen e tyre, për riparim dhe ndërtuar në qytet e fshate, si dhe me punën organizuese të përurimeve.

Gjatë një periudhe të gjate ka mbajtur vase (ligjërata) në shumë xhamia si në ditë xhumaje dhe për ceremoniale të ndryshme si në Bushat, Mjedë, Melgushë, Shkjezë, Mes-Myselim, Kullaj, Drisht, Ura Shtrenjtë, Grudë-Fushë, Jubicë, Laçaj, Shirq, Shirokë, Kiras, "Ebu Bekër", Plumbit, Ganjollë, Kosmaç, Teqen e Rufaive në Shkodër, Berat dhe Krujë. Në xhamitë e Beratit, Prizrenit dhe Ulqinit, Sarandë, Peshkopi, Pukë, Kavajë, Vlorë, Lezhë, Krujë e në mënyrë të veçantë në xhaminë e Rusit.

Prej vitit 1996 dhe deri 2021 ka qenë mësues besimi në xhaminë e Rusit.

EMËRIMET

Nga viti 1992 e deri 1996, me vendim të Myftiut të Shkodrës dhe të këshillit të Myftinisë ka qenë emëruar në rolin e zv/Myftiut.

Në vitin 1996, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë e emëron Vaiz i Shkodrës

Nga viti 2001 deri 2021 imam dhe hatib në xhaminë e Rusit.

Në vitin 2009, dekret nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, emërim Ndihmës/Myfti i Zonës Shkodër.

DETYRA NË FUNKSION TË BESIMIT DHE TË SHOQËRISË

Nga viti 1992 anëtar i Këshillit të Myftinisë Shkodër dhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë deri në vitin 2006.

Në vitin 2007 deri 2011 anëtar dhe sekretar i Këshillit të Myftinisë Shkodër.

Në vitin 2015 dhe në vazhdim anëtar dhe sekretar i Këshillit të Myftinisë Shkodër.

VEPRIMTARI TË TJERA

Ka qenë nismëtari kryesor i krijimit të shoqatës se intelektualeve "Kultura

Islame" dega Shkodër në vitin 1995 dhe nga ai vit e deri 2005 ka qenë sekretar i saj.

Ka qenë përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër në pajtimet e gjaqeve dhe ndalimin e konflikteve.

NGJARJET E VITIT 1997

Në vitin 1997 në bashkëpunim me Komunitet e tjera fetare ka dale rrugë më rrugë, derë më derë në mitingje, lëvizje në këmbë e me mjete për të evituar vrasjet ndërmjet besimeve, se kështu trumbetohej. Ka bashkëpunuar me media dhe po ashtu në minaret e xhamisë ishin të lidhur me stacionet e Radios dhe TV, ku jepnim herë pas here mesazhe paqeje dhe dashurie, që të uleshin armët.

Gjatë vitit 1997 deri në 1998 ka qenë përfaqësues i Myftinisë Shkodër çdo ditë në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, Qarkut, Prefekturës, etj, rreth trazirave të kohës.

Ka marrë pjesë në të gjitha takimet me Ministrin e Brendshëm, në Kryeministri, Kuvend e në Presidencë, në takimet me të huajt si dhe në takimet me Vranickin, si përfaqësues i OSBE-së.

Ka organizuar me të tjerët pjesëtarë të komuniteteve, dorëzim armesh në Shkodër, Lezhë, Pukë dhe Rrëshen.

Në periudhën e ardhjes së vëllezërve kosovarë në Shkodër, si përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër ka bashkëpunuar me Prefekturën, me organizata shtetërore, komunitet fetare, shoqata islame, që kanë dhënë një ndihmesë të madhe.

Ka marrë pjesë në simpoziume e sezone shkencore, takime e konferenca kombëtare e ndërkombëtare për problemet fetare e sociale kundër drogës, alkoolit, duhanit, etj.

Ka drejtuar për 13 vjet emisionin në Radio Shkodra të titulluar: "Kulturë Islame". Ka përgatitur rreth 1500 materiale teologjike, filozofie, sociale, historie, figura të ndryshme dhe Traditë Profetike.

Ka kryer mbi 1500 kurorëzime në xhaminë e Fushë Çelës, etj.

Ka shkruar në gazetën "Drita Islame" rreth 250 artikuj të spektrave të ndryshëm si dhe në gazetën "Udha Islame", në revistën "Njeriu", "Tribuna Demokratike", "Shkodra", "Drita e Dijes", etj.

DETYRAT SHTETËRORE

Ka punuar inxhinier pyjesh dhe njëkohësisht Përgjegjës Sektori në Dukagjin, Postribë, Shllak, Malësi e Madhe, Nënshkodër, Oblike – Ana Malit ,Vau Dejës dhe Shkodër.

Shef i shfrytëzimi të pyjeve të rrethit Shkodër.

Pedagog në teknikumin e pyjeve – 5 vjet.

Anëtar i rrethit Shkencor të pyjeve – 20 vjet.

Ka përfunduar studimin mbi përhapjen e bimëve medicinale në rrethin e Shkodrës.

Ka përfunduar studimin e përmasimit të pyjeve të pishave në Mnel Vig, qe zbatohet edhe sot,

Ka përfunduar studimin e zonës Theth, Breg Lumi, Toplanë, që janë zbatuar për mbjelle pishash dhe sot janë masive të mëdha.

Ka përfunduar studimin e shelgjishteve të Rrethit për prodhim thupra ku jene punësuar 400 punëtorë në ndërmarrjen e Zukthave. Studimi ka qenë parashikuar deri 1995.

ISHUJT KOMORE, OSE XHUZUR EL-KAMER

Ishujt Komore, ose Xhuzur El-Kamer, që në arabisht do të thotë "Ishujt e Hënës", është një shtet ishullor që ndodhet afërsisht 290 km larg brigjeve të Afrikës Lindore, në skajin verior të Kanalit Mozambik, dhe përbëhet nga tre ishuj kryesorë: Grande Comore (Komorja e Madhe), Mohéli dhe Anzhuān. Ky shtet gjithashtu pretendon një ishull të katërt të madh, ishullin Majot (Maore), që gjendet në pjesën juglindore të tyre, dhe që administrohet nga Franca, si një departament i saj jashtë vendit.

Shteti i Komoreve, zyrtarisht, njihet si "Unioni i Komoreve".

Ky shtet ndan kufij detarë me Sishel (Seychelles) në verilindje, me Madagaskarin dhe Majotën në juglindje, me Tanzaninë në veriperëndim, dhe me Mozambikun në perëndim.

Kryeqyteti i shtetit është Moroni, që është edhe qyteti më i madh i ishujve.

Si një anëtar i Lidhjes Arabe, Ishujt Komore është i vetmi shtet i Botës Arabe që gjendet tërësisht në Hemisferën Jugore.

Kur flitet për sipërfaqen e vendit, bëhet fjalë vetëm për sipërfaqen e tre ishujve që përbëjnë shtetin e pavarur të Komoreve, dhe ka një sipërfaqe prej 1,861 km2 , që konsiderohet edhe shteti i katërt më i vogël Afrikan për nga sipërfaqja. Popullsia e vendit numërohet të jetë 885.339 banorë (Prill, 2021).

GJEOGRAFIA E VENDIT

Komorja e madhe, Mohéli, Anzhuān dhe Mahori (Majot), janë ishujt kryesorë në arkipelagun e Komoreve, të cilët rrethohen edhe nga shumë ishuj më të vegjël.

Ishujt kanë dalë nga fundi i Oqeanit Indian, si rezultat i aktivitetit vullkanik.

Komorja e Madhe (Grande Comore), është më i madhi dhe më i larti i atyre ishujve. Relievi i tij shkon duke u ngritur drejt skajit të tij jugor, dhe përfundon në një vullkan aktiv, në malin Kartala (2.361 m), që është edhe pika më e lartë e vendit. Kartala ka shpërthyer shumë herë gjatë dy shekujve të fundit. Kryeqyteti, Moroni, shtrihet nën hijen e vullkanit, përgjatë bregdetit perëndimor të ishullit, ndërsa në anën veriore të këtij ishulli shtrihet qyteti Mitsamiūli. Në veri të malit Kartala , gjendet një pllajë e gjerë me një lartësi mesatare prej 600 metrash. Sipërfaqja e ishullit është përgjithësisht shkëmbore, tokat e tij janë të ulëta dhe nuk ka në të rrjedha ujore shumëvjeçare. Ndërsa bregdeti, i cili nuk ka hyrje të mëdha, është i papërshtatshëm për transport.

Mohéli (Mauāli) është ishulli më i vogël i grupit. I përbërë kryesisht nga një pllajë që sillet rreth 300 metrave lartësi, ishulli përfundon në perëndim në një kreshtë që arrin në më shumë se 790 metra mbi nivelin e detit. Luginat në ishull janë përgjithësisht pjellore, dhe kodrat janë të mbuluara me pyje të dendura. Një dallgë e fortë deti në brigjet e tij, e vështirëson transportin atje. Qytetet kryesore të Mohéli-t janë: Fomboni, në bregdetin verior, dhe Nioumachoua, në jugperëndim.

Anzhuān është një ishull në formë trekëndëshi, që vjen duke u ngritur në qendër në një masiv vullkanik (mali Ntingui), i cili arrin një lartësi prej rreth 1.580 metrash. Megjithëse shtresa e sipërfaqes së tokës është e mirë, erozioni i shumtë që ka ndodhur, ka bërë që shumë zona të mos jenë më të punueshme. Ishulli nuk ka porte të mira natyrore. Qyteti Moutsamudū, në bregdetin veriperëndimor, është qyteti kryesor në ishull, porti i të cilit është modernizuar në mesin e viteve 1980.

Në juglindje të Anzhuanit shtrihet ishulli Majot (Mahori), i cili pretendohet nga Komoret, por statusi i tij është i pazgjidhur dhe vazhdon të administrohet nga Franca.

KLIMA

Klima është përgjithësisht tropikale dhe e butë, dhe ka dy sezone kryesore me një sasi të konsiderueshme të reshjeve. Temperatura arrin 29-30 gradë C, në mars, i cili është muaji më i nxehtë i sezonit të shirave, sezon i cili zgjat nga dhjetori deri në prill. Nga ana tjetër, temperatura bie në 19 gradë celsius, në sezonin e ftohtë dhe të thatë, i cili zgjat nga maji deri në nëntor. Gjatë sezonit të shirave, ishujt janë të ekspozuar ndaj uraganeve, të cilat janë mjaft të forta për ta shkatërruar infrastrukturën dy herë në dekadë.

EKONOMIA

Komoret konsiderohen si një nga shtetet më të varfra të botës. Ekonomia atje bazohet në bujqësi dhe peshkim. Prodhimi i brendshëm bruto i vendit në përgjithësi është rritur me një shpejtësi pak më të shpejtë se popullsia, por është ndër më të ulëtat në botë. Prodhimi në përgjithësi është i kufizuar në përpunimin e produkteve bujqësore - kryesisht vaniljes, vajrave esenciale, karafilit dhe koprës - për eksport. Në vend gjithashtu gjenden edhe sharrat dhe fabrikat e përpunimit të drurit. Importet, që vlerësohen të kenë një nivel shumë më të lartë se të eksporteve, përfshijnë orizin, naftën, mishin, hekurin, çelikun dhe çimenton. Komoret tregtojnë me disa vende, përfshirë Holandën, Kinën, Singaporin, Pakistanin, Indinë dhe Francën, dhe vendi është anëtar i Komunitetit të Zhvillimit të Afrikës Jugore.

Që nga pavarësia (viti 1975), ndihmat nga Bashkimi Evropian, veçanërisht nga Franca, kanë qenë mbështetja kryesore e ekonomisë së Komoreve. Arabia Saudite, Japonia dhe Kuvajti, kanë dhënë gjithashtu ndihma financiare për ta.

GJUHA

Gjuha arabe dhe ajo frënge janë gjuhë zyrtare atje, përkrah gjuhës komore. Gjuha arabe është e njohur gjerësisht si gjuhë e dytë, që është edhe gjuha e Shkencave Kuranore. Frëngjishtja është gjuha administrative, dhe përdoret për të gjitha format e arsimit zyrtar, jo-Kuranor.

Gjuhët më të përhapura në Komore janë gjuhët Komore, të njohura përgjithësisht si Shikomori. Ato kanë lidhje me Suahilishten, dhe të katër variantet e ndryshme të saj (Shingazidja, Shimuali, Shindzuani dhe Shimaore), fliten në secilin nga katër ishujt. Në vend përdoren shkrimi arab edhe ai latin. Shkrimi arab është i përdorur më gjerësisht dhe kohëve të fundit është zhvilluar një drejtshkrim zyrtar për shkrimin latin.

FEJA

Islami Sunit është feja dominuese në vend, i ndjekur nga rreth 99% të popullsisë. Komoret janë i vetmi vend me shumicë myslimane në Afrikën Jugore, dhe territori i dytë me shumicë myslimane në jug, pas territorit francez të Majotës. Të krishterët përbëjnë një pakicë të popullsisë së Komoreve.

HISTORI

Besohet se banorët e parë të Komoreve ishin kolonë nga Polinezia, Melanezia, Malajzia, Indonezia dhe Austronesia, që kishin ardhur atje me anije. Ata u vendosën në ata ishuj në shekullin e gjashtë pas Isait (a.s), dhe kjo është ajo që konfirmohet nga kërkimet e para arkeologjike të bëra në Anzhuān, megjithëse disa burime hamendësojnë se njerëzit mund të kenë banuar atje që në shekullin e parë të erës sonë.

Zhvillimi i Komoreve ndahet në faza. Faza më e hershme e regjistruar në mënyrë të besueshme është faza Dembeni (shekujt 8-10), kohë gjatë së cilës në secilin ishull kishte disa vendbanime të vogla. Nga shekulli 11-të e deri në shekullin e 15-të, lulëzoi tregtia me ishullin e Madagaskarit, si edhe me tregtarët nga bregdeti Suahili dhe nga Lindja e Mesme. Gjatë kësaj kohe u themeluan më shumë fshatra, dhe fshatrat ekzistuese u rritën. Shumë komoras mund të gjejnë se paraardhësit e tyre kanë qenë arabë, sidomos nga Hadrameuti i Jemenit, të cilët kishin ardhur atje gjatë kësaj periudhe.

Në fund të shekullit të 15-të, në Oqeanin Indian arritën portugezët, dhe vizita e parë e portugezëve në Ishujt Komore, duket të ketë qenë ajo e flotës së dytë të Vasko de Gamës, në vitin 1503. Ishujt siguruan furnizime për fortesën Portugeze në Mozambik, për pjesën më të madhe të shekullit të 16-të, dhe megjithëse nuk kishte asnjë përpjekje zyrtare nga kurora portugeze për të marrë në zotërim atë vend, një numër tregtarësh portugez u vendosën në Komore.

Në fund të shekullit të 16-të, me mbështetjen e Sulltanit të Omanit, Seif ibn Sulltan, komorasit filluan t'i mposhtnin holandezët dhe portugezët. Pasardhësi i tij, Saíd ibn Sulltan, e rriti ndikimin arab (të Omanit) në rajon, pas zhvendosjes së administratës së tij në Zanzibar-in aty pranë, i cili u vu nën sundimin e Omanit.

Në dekadën e fundit të shekullit të 18-të, luftëtarët Malagasy, kryesisht Betsimisaraka dhe Sakalava, filluan të sulmonin Komoret për skllevër. Si rezultat, ishujt u rrënuan, të korrat u shkatërruan, dhe njerëzit u vranë, u morën robër ose u larguan në kontinentin Afrikan, saqë thuhet se kur sulmet përfunduan, në dekadën e dytë të shekullit të 19-të, në Mohéli mbeti vetëm një burrë. Më pas, ishujt u ripopulluan nga skllevër të sjellë nga pjesa kontinentale, të cilët u tregtoheshin francezëve në Majotë dhe në Maskarene. Në vitin 1865, vlerësohej se deri 40% e popullsisë së Komoreve përbëhej nga skllevërit.

Franca vendosi për herë të parë sundimin e saj kolonial në Ishujt Komore, duke marrë në zotërim ishullin Majot, në vitin 1841, atëherë kur sulltani uzurpator nga komuniteti Sakalava, Andrian Tsoli, i njohur edhe si Tsy Levalo, nënshkroi Traktatin e Prillit të vitit 1841, sipas të cilit ua dorëzoi ishullin autoriteteve Franceze.

Në vitin 1886, ishulli Mohéli u vendos nën mbrojtjen franceze, me kërkesë nga mbretëresha Salimba Mushimba. Në të njëjtin vit, sulltani Saíd Ali, pas forcimit të autoritetit të tij mbi Ishullin e Komores së Madhe, pranoi protektoratin francez, por, pavarësisht kësaj, ai e mbajti sovranitetin deri në vitin 1909. Gjithashtu, në vitin 1909, sulltani Saíd Muhamed, sulltani i Anzhuān-it, hoqi dorë nga froni, në favor të qeverisjes franceze. Në vitin 1912, Ishujt Komore u bënë tërësisht një koloni zyrtare franceze. Në vitin 1941, ishujt u vendosën nën sundimin e Guvernatorit të Përgjithshëm të Kolonializmit Francez, me seli në Madagaskar.

Në vitin në 1973, u arrit një marrëveshje me Francën, në lidhje me pavarësinë e Ishujve Komore në vitin 1978. Megjithëkëtë, me 6 korrik të vitit 1975, parlamenti i Komoreve lëshoi një vendim të njëanshëm, që shpallte pavarësinë e ishujve. Deputetët e ishullit Majota abstenuan. Në të katër ishujt u mbajtën referendume. Tre ishuj votuan për pavarësi, kurse ishulli Majotë votoi kundër pavarësisë, dhe qëndroi nën sundimin francez. Me 5 Shtator të vitit 1975, Ahmed Abdullah deklaroi pavarësinë e Shtetit të Ishujve Komore, dhe u bë presidenti i parë i këtij shteti.

SI HYRI ISLAMI NË ISHUJT KOMORE

Tregtarët nga Lindja e Mesme ishin të parët që e futën Islamin në këta ishuj. Këtë e dëshmon edhe emri që këta ishuj mbajnë: "Xhuzur El-Kamer – Ishujt e Hënës".

Në vitin 933 të erës sonë, Komoret njiheshin nga marinarët e Omanit si "Ishujt e Parfumeve", për shkak të aromës së bimës yjlang-yjlangut të verdhë, të gjendur atje, që është edhe një përbërës kryesor i cili përdoret për prodhimin e vajrave më të mirë esencial në botë.

Mes rrëfimeve më të hershme rreth Afrikës Lindore, punimet e El-Mes'ūdit përshkruajnë rrugët e hershme tregtare të muslimanëve, dhe aty thuhet se brigjet e Afrikës dhe ishujt e ndryshëm, vizitoheshin shpesh nga myslimanët, përfshirë tregtarët dhe marinarët persianë edhe arabë, që dilnin në kërkim të koraleve, amberit, fildishit, arit, etj. Ata sollën Islamin te banorët e atyre viseve, përfshirë edhe banorët e Ishujve Komore.

Marrëdhëniet tregtare mes arabëve dhe Afrikës Lindore kanë ekzistuar që nga kohërat e lashta. Kështu që, kur në vendet arabe u përhap Islami, ai u zhvendos edhe në Afrikën Lindore dhe në brigjet e saj, përmes tregtarëve, predikuesve, dhe migrimeve të shkaktuara shpeshherë si rezultat i ngjarjeve dhe rrethanave politike në Gadishullin Arabik. Ata u tërhoqën drejt atyre viseve, për shkak të lidhjeve të lashta që kishin me to, dhe për shkak të lehtësisë së transportit në ato brigje. Shënimet historike tregojnë se shumë muslimanë Shirazë nga Persia, por edhe të tjerë nga Omani, El-Ah'sa dhe Jemeni, dhe u vendosën në Afrikën Lindore.

Të gjithë këta myslimanë u vendosën përgjatë bregdetit lindor të Afrikës, pa depërtuar në brendësi të kontinentit. Në shumicën e rasteve profesioni i këtyre emigrantëve ishte tregtia, e cila e lehtësonte komunikimin me popullsinë vendase, dhe gjithashtu e bënte të lehtë thirrjen e atyre njerëzve në Islam. Këta myslimanë arritën të krijonin atje qendra të mëdha tregtare, më të famshmet prej të cilave janë Kilva, Dār Es-Selām, Sofala, Malindi, e të tjerë, dhe siç e përmend Ibn Bat'tūta, ato ishin qendra që karakterizoheshin nga një civilizim i nivelit të lartë. Ndërkohë që rëndësia e ishujve Komoreve po rritej përgjatë bregdetit të Afrikës Lindore, në to u ndërtuan edhe xhami, të vogla dhe të mëdha.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org
https://www.worldometers.info
https://ar.wikipedia.org
https://www.marefa.org
https://www.britannica.com

RAMAZANI, “ANIJA E SHPËTIMIT”

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Dijetarët myslimianë nëpërmjet shembujve dhe krahasimeve të ndryshme janë munduar që të na e qartësojnë se si ne duhet ta shfrytëzojmë dhe ta kuptojmë këtë muaj. Një ndër krahasimet që kanë bërë dijetarët është se e kanë krahasuar këtë muaj me detin.

Ramazani është sikur deti, nga i cili ka dobi të shumta. Allahu i Lartësuar na begatoi duke nënshtruar për ne detin, që të ushqehemi me mishin e gjallesave që gjenden në të; të nxjerrim perla dhe margaritarët që ai ruan në thellësitë e tij; të lundrojmë në të etj.

Për Musan (a.s) u ça deti dhe për të u bë shpëtim, ndërsa faraoni ndoqi po të njëjtën rrugë, por me qëllim të keq dhe deti u bë përfundim për të.

Allahu (xh.sh) kur flet për detin në Kur’an thotë: “Është Ai që e nënshtroi detin, që ju të hani prej tij mish të freskët e të nxirrni nga ai stoli të shumta që ju i mbani. Ju i shihni anijet si çajnë nëpër të, që të kërkoni nga begatitë e Tij dhe të jeni falënderues (për Zotin).”[1]

A kemi ne, anije të përshtatshme që të lundrojmë në këtë muaj e t’i gëzohemi takimit tonë me Allahun e Madhëruar?

Çfarë duhet të kontrollojmë në këtë muaj që ai të na bartë të sigurt deri në breg, i cili është takimi me Allahun e Lartësuar.

1. Gjatë muajit të Ramazanit kërkohet nga ne arritja e devotshmërisë. Allahu (xh.sh) e ka obliguar agjërimin, me qëllim që besimtari të arrijë përkushtimin. Ai thotë: “O ju që besuat! Agjërimi është bërë obligim për ju, sikurse ka qenë edhe për ata që ishin para jush, me qëllim që të ruheni (nga gjynahet) dhe të arrini devotshmërinë.”[2] Devotshmëria përfshin kryerjen e çdo pune të mirë dhe largimin nga çdo punë e keqe.

2. Falja e gjynaheve. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe bindje duke shpresuar shpërblimin nga Allahu, i falen të gjitha gjynahet.”[3]

Nga sot mundohu që çdo lëvizje e jotja të jetë në përputhje me besimin dhe të jetë me qëllim të arritjes së shpërblimit të madh nga ana e Allahut. Kush hyn me këtë botëkuptim në ramazan do të arrijë atë që duhet arritur në këtë muaj.

Kab ibn Uxhrah (r.a) tregon: “I Dërguari i Allahut (a.s) na tha: “Afrohuni afër minberit”. Ne u afruam. Kur i Dërguari i Allahut qëndroi në shkallën e parë, tha: “Amin”. Kështu tha edhe në shkallën e dytë, edhe në shkallën e tretë. Pasi mbaroi predikimin, i thamë: “O i Dërguari i Allahut! Dëgjuam prej teje sot diçka, që nuk e kemi dëgjuar herë të tjera”. Ai (a.s) tha: “Xhibrili (a.s) u shfaq para meje dhe më tha tre gjëra: “Mallkuar qoftë ai që e arrin Ramazanin dhe nuk i falen gjynahet.” Unë thashë: “Amin”. Ai tha:“Mallkuar qoftë ai, që e dëgjon emrin tënd dhe nuk të përshëndet me salavat”. Unë thashë përsëri “Amin”. Xhibrili (a.s) tha: “Mallkuar qoftë ai, që i ka të dy prindërit apo njërin prej tyre gjallë dhe nuk hyn në xhenet (nëpërmjet bamirësisë ndaj tyre)”. Unë thashë: “Amin”.[4]

3. T’i kontrollojmë fjalët tona. Kush hyn në këtë muaj pa e trajtuar gjuhën siç duhet rrezikon agjërimin e Ramazanit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush nuk e lë gënjeshtrën[5] dhe punën me të, Allahu nuk ka nevojë që ai ta mbajë barkun bosh.”[6]

Shumica e dijetarëve kanë rënë dakord se agjëruesi që bën përgojim, gënjen apo sillet keq me të tjerët, ai nuk e prish atë ditë agjërimi me këtë veprim, por merr gjynah dhe i pakësohet shpërblimi.[7]

Gënjeshtra është baza e paturpësive dhe burimi i gjynaheve. Për këtë arsye, ajo është përmendur krahas me shirkun në ajetin: “Largohuni nga ndotësia e idhujve dhe largohuni nga çdo fjalë e kotë dhe gënjeshtër.”[8] Dihet se shirku

1. Kurani, En-Nahl: 14.
2. Kurani, El-Bekare: 183.
3. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
4. Hadith i saktë, transmetuar nga Hakimi.
5. Këtu hyjnë të gjitha gjynahet e gjuhës si: dëshmia e rremë, shpifja, gënjeshtra, sharja, mallkimi etj.
6. Transmetuar nga Buhariu.
7. Ibn Haxher, Fet’hul-Bari, 4/104; Umdetu’l-Karii, 10/276.
8. Kurani, El-Haxh: 30.

është e kundërta e sinqeritetit, ndërsa tipar kryesor i agjërimit është vërtetësia e sinqeritetit, prandaj nëse agjërimi bashkohet me gënjeshtrën, të kundërtën e tij, atëherë ai asgjësohet.”[9]

4. Nëse kemi mosmarrëveshje me njëri-tjetrin të pajtohemi dhe të falim njëri-tjetrin në mënyrë që edhe Allahu të na falë neve.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu i Lartësuar në natën e gjysmës së muajit Shaban ua fal gjynahet të gjitha krijesave të Tij, përveç atyre: që i bëjnë shok Allahut, ata që janë në armiqësi me njëri-tjetrin.”[10]

Ebu Bekri (r.a), vazhdimisht i gjendej në ndihmë Mistahut[11] dhe familjes së tij. Kur pa që edhe ai bënte pjesë në grupin që po shpifnin për vajzën e tij, Aishen (r.anha) ai u betua se nuk do ta ndihmonte më as atë e as familjen e tij. Me këtë rast Allahu i Madhëruar zbriti këtë ajet: “Bamirësit dhe të pasurit të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që i lanë shtëpitë e tyre për hir të Allahut, por le t’ua falin (gabimin) dhe të mos ua vënë re. A nuk dëshironi që Allahu t’ju falë juve?...”[12],[13] Kur Profeti (a.s) e lexoi këtë ajet, Ebu Bekri (r.a) tha: “Natyrisht, unë dua që Allahu të më falë!” dhe iu kthye sërish ndihmës financiare për Mistahun dhe familjen e tij, ashtu si më parë. Ebu Bekri i sinqertë sapo dëgjoi thirrjen e Zotit të tij për falje, iu përgjigj menjëherë thirrjes së Allahut, qetësisht dhe sinqerisht...[14]

Prandaj edhe ne ta falim njëri-tjetrin e të hyjmë në këtë muaj të pajtuar, të bashkuar dhe të dashur me njëri-tjetrin në mënyrë që Allahu të na falë neve.

E lusim Allahun e Madhëruar që këtë Ramazan ta bëjë shpëtim për ne, ashtu sikur e bëri detin shpëtim për Musain (a.s) e jo përmbytje siç ishte për faraonin.

9. Këtë shpjegim e citon Menavi nga Ettijbi. Shiko: Menavi, Fejdul-Kadir, 6/224.
10. Transmetuar nga Ibn Maxheh.
11. Mistah ibn Uthethe lindi në vitin 22 para hixhretit, 601 diellor dhe ndërroi jetë në vitin 34 hixhri, 654 diellor. Mistahu është sahabi prej Kujeshëve. Emri i tij ishte Auf, por më shumë u njoh me pseudonimin e tij Mistah. Nëna e tij ishte vajza e tezes së Ebu Bekrit (r.a), i cili i ndihmonte ata financiarisht.
12. Kurani, En-Nur: 22.
13. Ky ajet zbriti enkas për Ebu Bekrin (r.a) kur u betua se nuk do t’i jepte lëmoshë Mistahut për shkak se mori pjesë në akuzim.
14. Edh-Dhilal, 4/1505, me autor Sejid Kutub.

RAMAZANI, PËRSE ËSHTË MUAJ I BEKUAR...

-ESE-



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Në fjalët e urta të dijetarëve islamë, në shprehjet proverbiale, në shumë mirësitë e fjalëve që shtohen çdo ditë e çdo vit për Ramazanin, në vlerësimin e tij shkëlqen dhe rrezaton maksima: “Ramazani është Muaj i Bekuar!”

Është muaj që në qiellin e zemrave të secilit Bekimet dhe Urimet rrjedhin parreshtur... Të pastra dhe të ëndërrta! Bekojnë njerëzit njëri-tjetrin, bekojnë gjyshërit dhe gjyshet njëri-tjetrin dhe njëkohësisht nipat dhe mbesat, bekon familja anëtarët e saj, bekon, bekon, bekon...

Në këto ditë të bekuara sikur njeriu ka një “pozicionim” të ri ndaj vetes, një vlerësim të ri, një gjykim të ri..., larg të përditshmes së zakonshme, larg ritualit të ditës e të çdo dite... Sikur është një tjetër jetë, një tjetër lumturi aty te vatra kur mblidhesh me të dashurit e zemrës...

Çdo ditë e Ramazanit fillon me bekime... E bekimet fillojnë nga zemra, nga shpirti. Nuk janë shumë festa me tipologji të tillë në botë dhe në rrugëtimin e vërtetë të njeriut për t’u bërë i vërtetë. Një ditë si çdo ditë e Ramazanit fillon me bekim e mbaron me bekim. E në këtë dritësim bekimesh lulëzojnë: gëzime pafund, dritësime pafund, rrezatime pafund, dlirësi e pastërti pafund, virtyte të çmueshme pafund... Çdo gjë në ditët e Ramazanit, me mirësinë e Allahut është e pafund... Edhe njerëzillëku, edhe komunikimi i zemrave, edhe bamirësia... edhe... është e pafund, sepse fillon nga shpirti. Kjo copëz jete që quhet Ramazan dhe ka shenjtërinë e saj, fillon dhe jeton si copëz jete brenda shpirtit tënd. Jetoje! Ndaj, ne jemi përgjegjës që ajo copëz jete e çmuar të mos vyshket, por të gjelbërojë përjetësisht. Sepse në atë copëz jete bashkëudhëtojnë e shpesh njëjtësohen njerëzorja me hyjnoren. E ta mbash këtë çmueshmëri brenda shpirtit tënd, do të thotë ditës dhe njerëzve t’u rrëfesh e t’u falësh mirësi, dritë, ngazëllim, dashuri... që, shpesh, në jetën tonë edhe mungon. Është t’u falësh bekim nga bekimet e Ramazanit!

Bekim, Muaj i bekuar i Ramazanit!

Mendoni një çast sikur të jeni nën qiellin e bekuar të Qabes së Madhnueshme, nën diellin rezëllitës e rrëzëshpresës të bekuar të saj ... Ato bekime janë për jetën e njeriut, për lumturinë e tij! Mendojeni një çast këtë BEKIM, thirreni, bëjeni pjesë të shpirtit dhe zemrës, dhe filloni ditën... Sa e bukur do të jetë ajo! E filloni, me këtë komunikimin me familjarët e tu, me të afërmit e më gjerë... Sa i bukur dhe frytëdhënës do të jetë ai... Por sa jetë do t’i shtoni jetës së bekuar !.. Vetë lumturia është BEKIM!..

Paçi BEKIMIN e muajit të BEKUAR të RAMAZANIT!

UBA SHPËRNDAN KALENDARËT E RAMAZANIT PËR MYFTININË SHKODËR

Paraditën e së mërkurës, më 31 mars 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt përfaqësuesin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA), z. Astrit Zharri.

Në një publikim në profilin e tij zyrtar në fb, Imam Sytari shkruan: "Pata kënaqësinë sot, të pres në një takim të përzemërt përfaqësuesin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (UBA), të nderuarin z. Astrit Zharri.

E falënderova përzemërsisht për kontributin e vyer të UBA-s për besimtarët e Shkodrës, kalendarin e muajit Ramazan për këtë vit.

Është një shembull shumë i mirë, që bizneset duhet ta marrin në konsideratë, sidomos në këtë muaj të begatë, ku të gjithë jemi të ftuar të bëjmë më të mirën për të dhënë e për të lënë gjurmë në këtë muaj bekimesh!

Shoqëria jonë shqiptare ka nevojë të promovojë përherë e më shumë datat dhe ngjarjet e shënuara të fesë, që janë njëkohësisht frymëzueset e tabanit qytetar e kombëtar.

Me zemër të mirë!".

MYFTIU FALËNDEROI BAMIRËSINË SAUDITE ME RASTIN E FILLIMIT TË RAMAZANIT 1442

Ditën e hënë, më 12 prill 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha një mesazh falënderimi dhe mirënjohjeje për bashkëpunimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së Mbretërisë Saudite, që mundësuan edhe këtë vit furnizimin me një sasi të konsiderueshme pakosh me ushqime për njerëzit në nevojë, që vijnë si pjesë e projektit bamirës të Qendrës së Mbretit Selman për Ndihma dhe Bamirësi.

Myftiu theksoi se kjo ndihmë bujare është pjesë e shpirtit të madh të bamirësisë dhe humanizmit, me të cilin karakterizohen muslimanët ndër shekuj.

Imam Sytari tha se kjo ndihmë e madhe për qindra familje në nevojë, është mënyra më e mirë e pritjes së Muajit Ramazan, në të cilin jemi të ftuar të mëshirohemi e të jemi solidarë me njëri-tjetrin.

MYFTIU I SHKODRËS PRITI DREJTORIN E FONDACIONIT "MIRËNJOHJA"

Ditën e martë paradite, më 6 prill 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari priti në një takim të ngrohtë, drejtorin e Fondacionit Humanitar "Mirënjohja", të nderuarin H. Samed Shehu, me bashkëpunëtorë e tij.

Fillimisht, Myftiu falënderoi përzemërsisht Fondacionin "Mirënjohja" për korrektësinë në komunikim, seriozitetin në këtë bashkëpunim në kufijtë e veprës, urtësinë dhe tiparet e bardha të eksperiencave të jetës, në mënyrë të veçantë për realizimin e projektit madhështor të xhamisë së lagjes Kiras nga Shteti i Kuvajtit!

Të dy titullarët ndanë momentin e marrjes në dorëzim të Certifikatës së Përdorimit të këtij objekti me vlerë, lëshuar nga Bashkia Shkodër dhe nënshkruar nga kryetarja Voltana Ademi.

Gjithashtu ata diskutuam për rrugët e mëtejshme të bashkëpunimit për projekte në dobi të komunitetit, sikurse Myftiu shprehu mirënjohjen për mbështetjen që ky fondacion jep për qindra jetimë dhe familjet e tyre në Shkodër.

MYFTINIA SHKODËR DHE FONDACIONIN "MIRËSIA" SHPËRNDAJNË NDIHMA NË KULLAJ, SHIRQ DHE MJEDË

Ditën e shtunë, më 17 prill 2021, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Fondacionin "Mirësia" shpërndanë pako ushqimore me rastin e muajit të begatë të Ramazanit, në fshatrat Kullaj, Shirq dhe Mjedë.

Këto bamirësi vijnë, si pjesë e projekteve të këtij muaji të begatë, ku besimtarë të shumtë brenda vendit e jashtë tij, vrapojnë për të dhuruar, që të gjithë të gëzojnë në Ramazan.

NDËRROI JETË IMAMI I NDERUAR, H. FADIL KRAJA

Të Allahut jemi dhe tek Allahu do të kthehemi!

Në moshën 87 vjeçare, ka ndërruar jetë sot, më 18 prill 2021, imami i nderuar, H. Fadil Kraja.

Myftinia Shkodër, shpreh ngushëllimet e saj për familjen dhe komunitetin, sikurse shpreh mirënjohjen më të thellë për kontributet e imamit të nderuar, që ishte një vullnetar i zellshëm në krah të Myftiut të Shkodrës, H. Fail Hoxha, në vitet më të vështira të organizimit të Myftinisë Shkodër, pas vitit 1990.

Për shumë vite, ai shërbeu si imam dhe vaiz në disa xhami të zonës Shkodër, ku dha kontributin e tij në të mirë të besimtarëve dhe aktivitetit fetar.

Ai ishte i palodhur dhe i papërtueshëm për të shërbyer me shumë përkushtim e dashamirësi, pa kërkuar shpërblime e falënderime!

Allahu i Madhëruar e pranoftë veprën e tij dhe e pranoftë në mesin e të përkushtuarve në xhenetet e Tij!

Namazi i xhenazes do të falet ditën e hënë, më 19 prill 2021, ora: 15.00, në xhaminë e Fushë Çelës ("Ebu Bekër").

SHKODRA DHE PRIZRENI NË TRADITËN E VËLLAZËRISË ISLAME

Ditën e martë, më 20 prill 2021, me ftesë të Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Mr. Besim Berisha, Myfti i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në iftarin tradicional që bashkon dy myftinitë e binjakëzuara në sofrën e vëllazërisë islame.

Ndonëse në kushtet e pandemisë, iftari simbolik, bashkoi në tryezën bujare drejtuesit e dy myftinive, që diskutuan edhe për frymën e bashkëpunimit dhe rritjen e tij në të ardhmen në të mirë të besimtarëve dhe dy qyteteve me traditë e histori.

Biseda vëllazërore me theks tek shërbimet plot përkushtim e largpamësi ndaj besimtarëve, botimet e bashkëpunimet e frutshme, i dhanë dritë kësaj vizite në këtë Muaj vlerash e besimi.

Myftiu ishte i ftuar edhe në emisionin: "Karvani i Ramazanit", në RTv Besa, ku foli mbi pozitën e

moshës së tretë në Islam.

Gjatë kësaj vizite në Prizren, Myftiu shoqërohej edhe nga drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, antari i Këshillit të Përgjithshëm i KMSh, z. Altin Loshi, sekretari organizativ i Myftinisë Shkodër, thirrësi islam Lavdrim Hamja dhe përgjegjësi i sektorit të rinisë në Myftininë e Shkodrës, teologu Ervil Kuçi.

VOTON MYFTIU I SHKODRËS

Të dielën, më 25 prill 2021, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed B. Sytari ka mbërritur në shkollën e mesme artistike "Prenk Jakova" të qytetit për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese në zgjedhjet e përgjithshme.

Në një deklaratë për mediet pas votimit Myftiu ka pohuar se këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e vendit.

"Një ditë e bukur me diell ashtu sikurse janë lutjet tona në këtë ditë të bekuar të Ramazanit që të jetë e ardhmja e Shqipërisë sonë të shtrenjtë me plot diell, plot dritë, plot siguri, plot përparim dhe plot mirëqenie për njerëzit në përgjithësi. Votimi im sot është një detyrim moral, qytetar dhe një obligim kombëtar" -, tha ndër të tjera.

Më tej, Imam Muhamed B. Sytari i bëri thirrje që të gjithë qytetarët të dalin dhe ta kryejnë këtë obligim dhe detyrë që në fund te kthehet një mirësi dhe shpresë për familjet e tyre, fëmijët dhe të ardhmen e vendit tonë.

"Zoti e bekoftë Shkodrën, Shqipërinë dhe më zemër të mirë." -, u shpreh Myfti i Shkodrës.

NË RRUGË TË MBARË QENDRA KULTURORE NË BARBULLUSH

Pasditen e së hënës, më 26 prill 2021, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari së bashku me drejtorin e Findacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, zhvilluan një inspektim për të parë nga afër punimet e nisura për realizimin e Qendrës Kulturore të xhamisë së fshatit Barbullush në Bashkinë Vau Dejës.

Myftiu shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimin me vlerë me Fondacionin "Mirësia", që mundësoi këtë projekt, që plotëson nevojat e xhamisë dhe rinisë së saj, në fshatin Barbullush.

Pas miratimit të dhënë nga Kryesia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të gjithë u angazhuan që kjo vepër të nisë me mbarësinë e Zotit, për të sjellë para besimtarëve dhe qytetarëve të kësaj zone këtë objekt të munguar e të kërkuar prej kohësh.

Myftinia Shkodër është e interesuar që përveç ndërtimit të xhamive të reja, të pajisë edhe disa prej xhamive të zonës me qendra kulturore, që do të shërbejnë shumë mirë për afrimin e rinisë dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e aktiviteteve të larmishme.

MYFTINIA SHKODËR NË NDIHMË TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA...

Ditën e martë paradite, më 27 prill 2021, Myftinia Shkodër me rastin e muajit të begatë të Ramazanit ka ndihmuar 30 familje të personave me aftësi të kufizuara, duke u shpërndarë nga një pako ushqimore.

Gjatë muajit të Ramazanit, Myftinia Shkodër përmes edhe shoqatave dhe fondacioneve, me të cilat bashkëpunon, ka ndihmuar me pako ushqimore dhjetëra familje në nevojë.

Myftinia Shkodër fton të gjithë ata që kanë mundësi, sidomos biznesmenët dhe tregtarët të kontribuojnë për projektet bamirëse, që Myftinia realizon me rastin e Ramazanit, por jo vetëm, në mënyrë që t'i ndihmojmë familjet në nevojë, të cilat për fat të keq, janë shtuar shumë kohëve të fundit.

MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT SHIRQ-MUSHAN

PAK HISTORI:

- Xhamia Shirq, ndodhet në Njësinë Administrative Dajç, Shkodër.

- Përbëhet prej rreth 140 familje. Fiset më të njohura janë në Shirq-Mushan janë: Mehmetaj, Mllojaj, Mujaj, Metalaj, Miriku, Oblika, Hurmi, etj.

- Me lejimin e besimeve fetare në Shqipëri, pas vitit 1990, banorët e fshtit Shirq-Mushan u mblodhën dhe vendosën ndërtimin e xhamisë së re me kontributet e tyre por edhe të Myftinisë Shkodër.

Ndërsa në dhjetor të vitit 2019 u rindërtua xhamia e re me minare përmes donatorëve nga Shteti i Kuvajtit.

- Në xhaminë e Shirqit nga viti i rihapjes deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve: Skënder Dani, Akil Duman, Agron Cokaj, Bërhan Bilani, Hysen Muça dhe imami aktual, Kujtim Cufaj.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 17 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2021, nxënës dhe nxënëse është rreth 320 nxënës.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në vazhdën e vizitave dhe takimeve të me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepet e mësim-besimit, më 13 mars 2021 përgjegjësi i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi takimin e radhës me nxënësit e kursit fetarë në xhaminë Shirq.

Teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi i pasionuar, i cili me përkushtim të vazhdueshëm mirëmban këto veprimtari mjaft të rëndësishme edukative dhe arsimore.

Pas këtij takimi, nxënësit e mejtepit kaluan së bashku një iftar, të përgatitur enkas për ta dhe të shoqëruar nga mësuesi i palodhur H. Kujtim Cufaj.

SHTATË URTËSI TË REJA TË AGJËRIMIT

Këtë udhëtim të bukur do ta vazhdojmë me disa urtësi të reja të një adhurimi madhështor, agjërimit, e të cilat, bazuar në hulumtime dhe studime, tash së voni i kanë zbuluar shkencëtarët...

Kur i sëmuri t'i ketë "çuar duart" nga mjekët dhe shpresa për shërim të ketë humbur ose është shumë e paktë, atëherë hapi më i qëlluar që merret është kthimi tek ilaçi që nuk kushton asgjë – agjërimi. Hulumtuesit në sekretet e shërimit kanë gjetur dobi të reja të agjërimit, e që në fakt janë të panumërta. Ata në fokus kanë patur spitalet e avancuara në të cilat mjekimi bëhet sipas sistemit shërues që mbështetet në agjërimin si bazë për shërim efektiv.

Në vijim keni një përmbledhje të rezultateve tek të cilat arritën tash së voni mjekët dhe ekspertët:

1. Hulumtimet në terren e që fokus grup patën një numër të madh të sëmurësh kanë vërtetuar se agjërimi shëron kancerin dhe se ndikon, në njërën anë, në bllokimin e qelizave kancerogjene dhe në anën tjetër, frenon shkaqet që shkaktojnë çrregullime në sistemin e punës së qelizave. Së këndejmi, mjekët porosisin për domosdoshmërinë e agjërimit si ilaç ruajtës, i cili pengon shndërrimin e qelizave të shëndosha në qeliza të infektuara me kancer.

Subhanallah! Është vërejtur dallim i madh në përqindjen e të goditurve me kancer ndërmjet atyre që agjërojnë, sidomos atyre që agjërojnë sipas mësimeve islame, dhe atyre që nuk agjërojnë!

2. Me avancimin dhe përparimin teknologjik dhe ndotjen që bartë me vete ky zhvillim, qoftë kjo ndotje me helme, apo ndotje energjike, ndotje zhurmuese për shkak të zhurmës dhe ndriçimit të tepërt gjatë natës, ekspertët kanë zbuluar një sekret të ri tek agjërimi disa ditor, i cili largon këto helme nga trupi pa efekte anësore. Kirurgët janë të paaftë për të larguar të gjitha helmet nga qelizat e trupit ngase trup përmban hiç më pak se disa miliardë qeliza, kështu që në këto raste agjërimi paraqitet për të pastruar këto qeliza pa ndonjë dëm. Kjo s'ka si të mos jetë sekret prej sekreteve të agjërimit.

3. Kush nuk vuan prej nesh nga brengat e shumta të kësaj kohe për shkak të problemeve materiale, psikike, shoqërore dhe të tjera si pasojë e shekullarizmit?! Ekonomia amerikane vetëm për problemet psikike paguan një kosto vjetore prej miliarda dollarësh edhe pse nuk sheh ndonjë rezultat konkret nga këto shpenzime. Ekspertët e fushave të ndryshme kanë vërtetuar se agjërimi ka ndikim marramendës në qetësimin dhe stabilizimin shpirtëror të njeriut si dhe në zgjidhjen e një mori të madhe problemesh shoqërore dhe familjare të tij.

4. Si sëmundje e kësaj kohe merret mbipesha e cila shkakton sëmundje tjera të rrezikshme si ato të zemrës, tensionit të gjakut, diabetit, kolesterolit, kurrizit, etj. realisht prej këtyre apo prej disa prej tyre vuan gjysma e shoqërisë. Me gjithë përparimin e mjeteve mjekuese, mjekët vazhdojnë me ngulm të vërtetojnë se agjërimi është shërimi i vetëm efektiv për të gjitha këto sëmundje. I Madhëruar qofsh o Allah!

5. Agjërimi është shërues nga shumë doke dhe zakone të këqija që shpërbëjnë shoqërinë, si konsumimi i duhanit, lëndëve narkotike, alkoolit, shikimit në gjëra të ndaluara. Nuk ka vend për tu çuditur për rëndësinë e agjërimit kur shohim se ata që preferojnë agjërimin si mënyrën më përfikte për shërim janë pikërisht mjekët jomyslimanë.

6. Rinia e sodit ankohen shume për pamundësi martese për shkak të ndërlikimit të procedurave të martesës dhe mos zbatimit të lehtësimeve islame përkatëse, kështu që në mungesë të një martese të ligjshme, ata nën presionin e epshit, bijnë në mëkat (amoralitet). Për të mbajtur të riun nën kontroll, mjekët porosisin që të konsumohet sa më pak ushqim dhe ujë, e mundësisht të agjërohet, ngase uria ia largon të riut mendimin nga harami apo e ndaluara dhe pakëson sekretimin e hormoneve përgjegjëse për këtë, kështu që agjëruesi ndien një rehati shpirtërore që nuk mund të përshkruhet.

7. Një studim i ri ka vërtetuar se agjërimi zgjat jetën e qelizave dhe ngrit sistemin imunitar të njeriut, e si rezultat agjëruesit në krahasim me të tjerët jetojnë më gjatë. Këto janë disa sekrete të agjërimit që ftojnë besimtarin të shijojë ëmbëlsinë e këtij adhurimi sidomos tash në Ramazan. Ngritja e fuqisë efektive tek agjëruesit si pasojë e abstenimit nga ushqimi dhe pija, dhe shtimi i fuqisë së qelizave imunitare për të kryer punën e tyre dhe për të freskuar dhe aktivizuar sistemin imunitar nënkupton një gjë të rëndësishme, dhe e cila është: fuqia e trupit të agjëruesit për të shëruar të gjitha sëmundjet pa përjashtim. O Zot, pa të meta je!

Përfundimisht, sado që të hulumtojmë për urtësi të agjërimit, fundin nuk do e arrijmë kurrë. Dobitë e agjërimit nuk mund të numërohen por retorika hyjnore është ajo që të gjitha këto urtësi na i përmbledh me pak fjalë: "Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju." - *(Kur'ani, el-Bekare, 184)*

E lusim Allahun që të na ndihmojë për agjërim dhe namaz jo vetëm në këtë muaj të madhërishëm të ramazanit por gjatë gjithë vitit, sikur që shpresojmë tek lexuesit tanë se këtë hulumtim që e kanë si dhuratë do ta shpërndajnë tek miqtë e tyre. Ndoshta Allahu na bën dobi me të gjithë neve!

(www.islamgjakova.net)

FJALË TË PATHËNA NË NJË INTERVISTË, LARG...

(Nga shënimet e Myftiut, Imam Muhamed Bardhyl Sytari)

Intervista e gjatë me gazetaren Graciela Kiri, mbrëmjen e 18 prillit 2021, për Alb UK Tv, në Londër, më riktheu vite pas në kohë, në ditët e fëmijërisë, prejardhjes sime familjare, shkollës fillore në "7 Nëntori", rihapjes së xhamisë së parë më 16 nëntor 1990, udhëtimit në Damask në 1993, vështirësive të ditëve të para, por edhe kënaqësinë e jetës në kërkim të dijes.

Gjatë bashkëbisedimit tonë, ishte e pamundur të mos shprehja mirënjohjen dhe falënderimet e thella për Hoxhën, H. Vehbi S. Gavoçi dhe të vëllanë besnik, H. Nuh Gavoçi, që besoj fort se Zoti i dërgoi nga larg në mesin tonë, për të na tërhequr drejt thirrjes së gjyshërve e katragjyshërve, që e lidhën zemrën dhe jetën e tyre me këtë fé, në shërbim të ymetit e atdheut, pa kërkuar famë e lavdi!

Kryemyftiun e Sirisë, H.T. Shejkh Ahmed Keftaro, murshidin e urtë e dijetarin vizionar, që ishte dhe ngeli unik në llojin e tij, në thirrjen e urtë, në thellësinë e leximit të fesë, në urtinë e përcjellë në çdo ligjëratë, takim e konferencë, por edhe shumë mësues e murshidë të urtë, me të cilët më bashkoi kaderi për të qenë ky që jam sot!

Diskutuam rreth përkufizimit të muslimanit në jetë, marrëdhënieve me librin dhe studimet, agjërimin e Ramazanit, familjen dhe fëmijët e mi, të cilëve i kam hyrë aq shumë në hak për shkak të udhëtimeve, aktiviteteve, takimeve, misionit e shërbimeve, që gjithësesi janë thirrja ime në këtë jetë!

Ishte e pashmangshme të mos flisja kalimthi për vitet e paharrueshme si mësues në Medresenë e Shkodrës, kujtimet e të cilave e tejkalojnë pragun e një interviste, sado të zgjasë.

Po ashtu vitet e drejtimit të Myftinisë Shkodër, mirënjohjen për kolegët e shokët e rrugës, në të cilën kemi hyrë prej shumë e shumë kohësh, e në të cilën jemi dorëzuar, përtej posteve e realiteteve me të cilat përballemi në jetë!

Mbi të gjitha, u ndjeva mirë në këtë bashkëbisedim, që lidhi Shkodrën me Londrën për rreth dy orë, që kaluan më shpejt se të mendosh për shtrenjtësinë e tyre, sidomos në këtë natë Ramazani!

PËRKUJDESJA PËR MOSHËN E TRETË NË ISLAM

Mbrëmë, në një bashkëbisedim rreth pozitës së moshës së tretë në Islam, së bashku me të nderuarit Orhan ef. Bislimaj dhe Faruk ef. Ukallo, në RTv Besa, në kuadër të emisionit të përnatshëm: "Karvani i Ramazanit", organizim i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren.

Rreth 15 shekuj më parë, Resulullahu (a.s), fliste qartë e në mënyrë të prerë se: "Prej madhërimit të Allahut është edhe nderimi i të thinjurit musliman", për të nxitur kujdesin dhe nderimin e më të moshuarve ndër ne!

Folëm rreth mirësisë dhe bekimeve të mëdha që ka prania e prindërve në mesin tonë, sikurse dhamë mesazhe drejtuar shoqërisë për të pasur në vëmendje më të moshuarit, për t'i falur dashuri e respekt, vëmendje e nderim, për t'i afruar e vlerësuar, për të marrë këshillat e tyre e për të bërë më të mirën e mundshme për mirëqenien dhe begatinë e tyre.

Në rrafsh universal, porosiste: "Sa herë që një i ri nderon një të moshuar, Allahu do t'i ngarkojë dikë që ta nderojë në moshë të thyer", duke na sinjalizuar se respekti për moshën e tretë nuk njeh kufinj në mesin e racës njerëzore!

Ishim të mendimit se duhet bërë akoma më shumë në drejtim të përkujdesjes për më të moshuarit, për të krijuar kushte të përshtatshme për shëndetin e tyre, anën ekonomike, atë kulturore, atë shpirtërore, etj.

TË GJITHË NEVOJTARË PËR FALJEN E ZOTIT TË TANËSISË!

Është mbresëlënës ajeti kuranor: "Ai është që e pranon pendimin e robërve të Vet...", i 25-ti i sures Esh-Shura!

Është ndër ajetete shpresës dhe optimizmit për këdo që i është ngushtuar jeta nga gjynahet, gabimet, hutimi e neglizhenca dhe, që kërkon të rinisë një jetë të re, i pa ngarkuar me frikën a kompleksin se dikush, kushdo qoftë, i njeh mirë "sekretet" e tij të së shkuarës!

Në Islam, jemi ftuar të hapim zemrën para duarve të Atij, në dorën e të Cilit është gjithësia!

Nuk ka nevojë, as është normale që të shkosh të dikush prej racës njerëzore për të marrë faljen e gjynaheve tua prej tij, sepse askush; as të dërguarit e Zotit, eulijatë, njerëzit e mirë, myftilerët e hoxhallarët, hafizlerët e dervishlerët, askush, nuk e ka këtë kompetencë dhe logjike të jetë kështu!

Vetëm Poseduesi i kësaj bote dhe Mbreti i ditës së llogarisë, Ai që ka në dorë gjithçka dhe të Cilit të gjithë i jemi qole, vetëm Ai, ka në dorë të na pranojë a refuzojë!

Të tjerët janë të gjithë njësoj në këtë pikë; të gjithë nevojtarë për mëshirën dhe faljen e Zotit të tanësisë!

Sa qetësi e madhe shpirtërore, sa lehtësim e rehati e brendshme, kur e mendon se, Allahu i Madhëruar na e ka dhënë mundësinë t'i drejtohemi e t'i hapim zemrën në çdo kohë, të kërkojmë mëshirën, faljen, mbarësinë, bekimet, razillekun e çdo gjë, pa protokolle, pa frikë, pa hezitim dhe të sigurtë se s'do na korisë, as në këtë botë, as në të përtejmen!

E mrekullueshme!

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË-MYFTINIA SHKODËR

Me zemër të mirë e plot begati muajin e begatë të Ramazanit!

Myftinia Shkodër ju uron:
Agjërim të lehtë dhe të pranuar tek Allahu!

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek